



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agjencia Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency



Data: 11.08.2017

Ref.: 705/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa nr.564/17, datë 20.07.2017 e BPrAL Kolegji "Universi" për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.587/17, datë 06.07.2017.
- II. Shfuqizohet vendimi i KSHC-së nr.587/17, datë 06.07.2017 për pezullim të akreditimit të programeve të studimit në BPrAL Kolegji "Universi".
- III. Lejohet regjistrimi i studentëve në programin e studimit:
 - Kulturë Fizike, Sport dhe Rekreacion, BSc, 180 ECTS.
- IV. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.650/16, datë 15.07.2016.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "Universi" me 20.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 587/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim BPrAL Kolegji "Universi" i është pezulluar akreditimi për programin e studimit: Kulturë Fizike, Sport dhe Rekreacion, BSc, 180 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL "Universi", është konstatuar që programi i cekura në pikën dy të këtij vendimi, akreditimi i të cilit është pezulluar me vendim të KSHC-së nr.587/17, datë 06.07.2017, tani i plotësojnë kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2.

Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Universi";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

